



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Data	10.12.21	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Nupri	Shtojcë	
01	370/01-	37476	-/.

KONTRATA PËR FURNIZIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Shefket Koxha – Menaxher i prokurimit**; në njërën anë dhe

N..P.SH "ONI DESIGN", nga **Prishtina** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga **Ilir Sadiku** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi , Paisja për Kuzhinë për nevojat e QEAP AGIMI

me numër Identifikues **KA652/21/104/136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të **Furnizimi , Paisja për Kuzhinë për nevojat e QEAP AGIMI**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **10.12.2021**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **10 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **Komuna Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë **LPP-04/L-042**. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **7,950.00 €**,
me fjalë (Shtatë mijë nënqindëpesëdhjetë euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të shërbimit nga ana e komisionit për pranim

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **Furnizimit**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me siellie profesionale, përmes një qyqkimi që ka fuqinë e

res-judicata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ilir Sadiku	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	10.11.2021	Data:	10.11.2021
Vula:		Vula:	



FURNIZIMI, TRANSPORTI DHE MONTIMI I PAISJEVE NË QEAP"Agimi"					
NR	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për nj.	Totali
0	Furnizimi, transporti dhe montimi: Robot kuzhine (Mikser) për brum dhe ëmbëlsira 10 kg, përziere i fuqishëm planetar, duhet të ketë tasin nga çeliku Inox, 10L me 3 shpejtësi ngritja e tasit me levë dhe çelës sigurie, me brojtes prej çeliku mbi tas nga materiali Inox, butoni start & stop, pesha 50-deri 60kg.	Copë	1	850.00	850.00
2	Furnizimi, transporti dhe montimi: Televizor me përmasat: 65" (165 cm), rezolucioni: 4K Ultra HD (3840 x 2160), Smart TV (webOS ThinQ AI 6.0), Google Assistant, Amazon Alexa, Airplay2, Active HDR, FILMMAKER MODE™, HGIGReal 4K, α5 AI Processor 4K, Wi-Fi, 2 x HDMI 1 x USB Optical, Zëri: 20W, AI Acoustic Tuning, Adaptive Sound Control, Marrësi: DVB-C/T2	Copë	6	840.00	5,040.00
3	Furnizimi, transporti dhe montimi: Fshesë elektrike, fuqia: 1700 W, Tipi i filtrit: EPA, Lloji i depozitës së pluhurit: Pa thes, Kapaciteti i ujit: 5 L, Funksionon për larjen me ujë,* Funksionon për mbledhjen e ujit,* Gjatësia e kabllit: 6 m;	Copë	2	90.00	180.00
4	Furnizimi, transporti dhe montimi: Lavatriçe me kapacitet deri në 10KG; Rrotullim me deri 1200 RPM; Permasat: 85x60x58cm; Energji: A+++ Niveli i zhurmes: 58dB; Programe: 15 Child Lock Anti-Rrudhe Anti-Alergj Super Rapid Wash Program per rroba delikate	Copë	1	800.00	800.00
5	Furnizimi, transporti dhe montimi: Shporet elektrik jo montues me dimensionet 85/50/60, funksione 5, pllaka 4, nxemsin e grillit, kapaciteti furres 43 l, temperatura maksimale 270c	Copë	1	250.00	250.00
6	Furnizimi, transporti dhe montimi: Shtupë me avull, Fuqia: 1500 W; Rregullim i rrjedhjes së avullit: 10g - 26g/min; Avull konstant deri në 28 min; Lloji i depozitës: Plastikë; Kapaciteti i rezervuarit të ujit të pastër: 0.55 L; Pastron dhe dizinfekton me avull në 110°C; Kokë rrotulluese deri 180°; Numri i aksesorëve: 10; Gjatësia e kabllit: 3 m;	Copë	6	80.00	480.00
7	Furnizimi, transporti dhe montimi: Enëlarëse jomontuese me kapacitet për 12 persona; Energjia: A++ ; Programe: 10 Memorje; Niveli i zhurmes: 52dB, Dimensionet e produktit: 81.5x60x55cm;	Copë	1	350.00	350.00
Totali					7,950.00

Kaçanik, nëntorr 2021

